



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 258/ prot.
16

Pogradec, më 17.01, 2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur, po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

“Për një ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 105, datë 02.12.2021 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave publike” dhe “harta që përcakton rrugët e qytetit, të cilat përjashtohen nga kjo rregullore”

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____.

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____.

Nr. i faqeve A3 të relacioni shoqërues ____.

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot

Pogradec, më ____ . ____ . 2024

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ . 2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 105,
DATË 02.12.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR
SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE” DHE “HARTA QË
PËRCAKTON RRUGËT E QYTETIT, TË CILAT PËRJASHTOHEN NGA
KJO RREGULLORE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja b, neni 23 pika 14, neni 54, neni 55, të ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 4/1 të Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 7, i ndryshuar, ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; VKM-së nr.1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, Ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 133, datë 11.12.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i bashkisë:

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në përcaktimin e hapësirave publike, me vendodhje në rrugën “10 Dëshmorët e Pojskës dhe rruga “Fan S. Noli”, Pogradec, sipas hartave bashkëlidhur për vendosjen strukturave sipas V.K.M – së Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 7, i ndryshuar.
- 1.2 Hartat e tjera publike të miratuara me V.K.B – në Nr. 105, datë 02.12.2021, mbeten të pandryshuara.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARE
MANJOLA KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Pogradec, më ____ . ____ . 2024

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin “Për një ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 105, datë 02.12.2021 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave publike” dhe “hartat që përcakton rrugët e qytetit,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore”.

E nderuar Kryetare e Këshillit!
Të nderuar Këshilltarë !

Bashkia Pogradec, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësive të saj si dhe nisur nga kërkesat e subjekteve private që ushtrojnë aktivitetet në zonën e rrugës “Fan Noli” dhe “10 Dëshmorët e Pojskës”, të cilët kërkojnë shfrytëzimin e hapësirës publike, jo vetëm gjatë sezonit veror por edhe gjatë pjesës tjetër të vitit për vendosje të strukturave sipas V.K.M – së Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 7, i ndryshuar; po paraqesimin ndryshimin me disa detaje të vogla të hartave të VKB – së Nr. 105, datë 02.12.2021.

Sipërfaqet e propozuara në kete projekt vendim të cilat do vihen në dispozicion të subjekteve private, janë në përputhje me projektet që ka hartuar Bashkia Pogradec dhe pritet të implementohen së shpejti.

Gjithashtu, ndertimi i strukturave të përkohshme në këto sipërfaqe do të përmirësojë ndjeshëm nga ana funksionale dhe arkitektonike këto rrugë.

Strukturat do të jenë të përkohshme dhe do të ndërtohen vetëm pas miratimit të projektit në zbatim të Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”,i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar Dhe do tu nënshtrohen të gjitha detyrimeve për pagesën e zënies së hapësirës publike, duke sjellë të ardhura shtesë në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Për këtë qëllim propozojmë ndryshimin e hartave ekzistuese të sipërcituara.

**Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.
Faleminderit!**

Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Taulant Fejzo

: Mariano Tasellari

Miratoi: Anxhela Piliñçi

Konfirmoi: Paskalino Ziko